



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

**RELACION TEKNIK**

(KONTRATA NR.5)

Mirëmbajtje me performance rruga: **"Qafë Mali - Fierzë"**

***Përshkrim i përgjithshëm.***

Aksi rrugor **"Qafë Mali – Fierzë"** 57.3 km është një segment rrugor pjesë e inventarit të Drejtorisë së Rajonit Verior Shkodër. Ky segment rrugor është pjesë e aksit kryesor që lidh qytetet e Pukës, Fushë Arrëzitet me Fierzën dhe qytetin e Bajram Currit. Segmenti klasifikohet si rrugë interurbane dytësore, me një karrexhatë, me dy korsi lëvizjeje (nga një për çdo sens), me dy bankina 50 cm të paasfaltuara. Gjeresia mesatare e pjesës kaluese të rrugës është 4.5 ml. Për nga shtrirja gjeografike ky segment rrugor kalon i gjithi nëpër një terren të theksuar malor, i cili përfshihet në të gjithë gjatësinë e tij si segment me mirëmbajtje dimërore.

Me poshte jane te paraqitur ne forme tabelare segmentet rrugore qe perbejne kete kontrate.

Nr.	Segmenti rrugor	Gjatësia (km)	KOORDINATA E PIKES SE FILLIMIT (WGS 84)		KOORDINATA E PIKES SE MBARIMIT (WGS 84)	
			N	E	N	E
1	Qafë Mali - Fierzë	57.3	42°06'00.4"	20°06'50.3"	42°15'21.9"	20°01'58.6"
Shuma (km):		57.3				

***Kushtet e inspektimit.***

Sot me datë 03.04.2024, në zbatim kontratën Nr.58 Prot. datë 01.02.2024 me objekt: Mirëmbajtje rutinë me performancë "Q.Mali-Fierze" 57.3 km nga sipërmarrësi "Marçeli" dhe "Shpresa-Al" shpk, kemi bërë inspektimin në terren të këtij segmenti rrugorë. Nisur nga fakti i gjendjes aktuale të disa prej veprave të artit, si urave b/a, tombinove e mureve mbajtëse, shtresave asfaltike barrierave mbrojtëse, etj., disa prej të cilëve janë shumë të amortizuara dhe rrezikojnë shembjen e tyre duke rrezikuar jetën e udhëtarëve në lëvizje që kalojnë me automjetet e tyre në këtë segment rrugorë bënë te domosdoshme ndërhyrje me punime rehabilitimi.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

Theksojmë se inspektimi jonë është i karakterit vizual dhe mendimet tona për nevojat për punime rehabilitimi do të shërbejnë për këtë segment rrugorë gjatë katër viteve të ardhshme.

***Përshkrimi i situatës aktuale të segmenteve rrugore .***

Gjatë zbatimit të kontratës së mëparshme të *Mirëmbajtje rutinë me performancë "Q.Mali-Fierze"57.3 km* vihet re një ndërhyrje kryesisht në riparime të pjesshme të shtresave asfaltike. Evidentohen dhe riparimi i disa mureve apo pusetave të tombinove. Ka një përmirësim të dukshëm të sinjalistikës vertikale dhe horizontale, duke shtuar edhe shumë elementë që nuk kanë qënë më përpara si shevrone apo përvijues anësorë. Gjithashtu rezultojnë edhe një shtim i konsiderueshëm i barrierave mbrojtëse metalike.

Por duke u nisur nga fakti se aksi rrugor kalon nëpër një terren të theksuar malor, dhe çdo vit përballet me kushte të vështira atmosferike, vërehet se ky aks rrugorë ka nevoja të metejshme në shtimin apo përmirësimin e të gjithë elementeve rrugore që përmendëm më sipër, pjesë të cilën do ta trajtojmë më hollësisht në pikat e mëposhtme.

***Evidentimi i problematikave dhe propozimi për zgjidhjen e tyre.***

- *Një problematikë që vlen të përmendet është dëmtimi i urës b/a në km 5.500 mbi përroin e vogël të fshatit Flet me hapsirë drite 4.6 meter, lartësi 5.5meter dhe gjerësi 5.2 meter, të cilës i është demtuar shpatulla prej betoni e krahut të majtë e plasaritur dhe e ndarë në dy pjesë si pasojë e amortizimit të sajë dhe rrezikon shembjen e urës. Gjithashtu ka gryerje të themeleve dhe të demtuar edhe muret e shpatullave në krahun e djatht në anën e poshtme të lumit. Për këtë arsye me anë të punimeve të rehabilitimit kemi parashikuar një rikonstrukcion rrënjësor të sajë me themele, ballna dhe shpaullave anësore të saj.*
- *Ura b/a në km 11.000 mbi përroin e vogël të fshatit Xath me hapsirë drite 3.4 meter, lartësi 6.5meter dhe gjerësi 7.0 meter, është demtuar dhe gërryer shtresa prej betonit deri në dy meter thellësi ndërmjet dy themeleve të kësaj ure gjë e cila rrezikon shembjen e themeleve të dy shpatullave, si rrjedhojë edhe të vetë ures.*
- *Në gjendje tepër kritike që rrezikohet shembja e sajë nga moment në moment është ura e vogël b/a në km 14.600 mbi përroin e fshatit Kulumri me hapsirë drite 2.2 meter, lartësi 2.5 meter dhe gjerësi 6.7 metër, të cilës i janë demtuar dhe shembur themelet dhe dy shpatullat e sajë me mur guri. Për këtë urë kërkohet marrjen e*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

masave të menjëhershme për rikonstruksionin e themeleve dhe dy shpatullave të sajë.

- Në segmentin rrugore Qafë Mali – Fierzë, të amortizuar që rrezikojnë shembjen e tyre dhe te pjesës mikaluere të rruges, janë disa mure mbajtës prej guri. Në gjendje të dëmtuar është muri mbajtës prej guri në km 2.750, një pjesë e të cilit në gjatësi L = 8 meter dhe lartësi rreth 2.5 metër, mur i cili është shembur rreth 60 përqind.
- Në gjendje të dëmtuar ndodhet edhe muri mbajtës prej guri në km 5.650, një pjesë e të cilit në gjatësi L = 12.5 meter dhe lartësi rreth 5.5 metër ka filluar shembjen
- Edhe muri mbajtës prej guri në km 11.000, një pjesë e të cilit në gjatësi L = 10.0 meter dhe lartësi rreth 4.5 metër ka filluar shembjen.
- Në gjendje të dëmtuar ndodhet edhe muri mbajtës prej guri në km 22.800, një pjesë e të cilit në gjatësi L = 15.0 meter dhe lartësi rreth 4 metër ka filluar shembjen.
- Në gjendje të dëmtuar ndodhet edhe themeli i murit mbajtës prej guri në daljen e urës b/a në km 49.550, një pjesë e të cilit në gjatësi L = 15.0 meter dhe lartësi rreth 2.5 metër, rrezikon shembjen.
- Mure mbajtëse të dëmtuara dhe te prishura plotësisht janë ndodhen edhe në km 40.100, km 42.100 dhe km 47.900.
- *Megjithëse rruga është përmirësuar nga ana e sinjlistikës vertikale, përseri kemi evidentuar të nevojshme disa përmirësime të mëtejshme që do nevojiten gjatë 4 viteve të ardhshme.*

***Parashikimi i punimeve të rehabilitimit.***

Për të lehtësuar mënyrën e paraqitjes së shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit, kemi menduar që sasi të këtyre punimeve të paraqesim fragmentuara dhe të grupuara në segmente prej 1 kilometri. Përzgjedhja e zërave të punimeve të rehabilitimit është bërë në bazën e eksperiencës që kemi në kontratat e mëparshme duke evidentuar zërat që kanë rezultuar me efektivitet me të lartë gjatë kontratave të shkuara, si dhe shtimin e disa zërave të rinj të cilët na kanë rezultuar të duhur për përdorim në situata të caktuara.

Volumet e punimeve të parashikuara për një periudhë 4 vjeçare sipas segmenteve respektive, janë paraqitur në tabelat e shpërndarjes së punimeve të rehabilitimit periodike.

**Tabela përmbledhëse e kategorisë së punimeve të rehabilitimit është :**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

Nr.Anë	Përshkrimi i punimit	Njesia	Sasia
	<b>1. PUNIME GERMIMI</b>		
3.119/a	Germim shkëmbi i coptuar me ekskavator 0.5 m <sup>3</sup> , shkëmb, në themele gjeresi ~2 m, me shkarkim në toke,	m3	350
3.95/b	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.25 m <sup>3</sup> , në kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në toke	m3	210
3.158/3a	Transport dheu me auto deri 3.0 km	m3	210
3.161/2	Rrafshim skarpate në germim, ekskavator 0.25m <sup>3</sup>	m2	950
	<b>2. PUNIME SHITRESASH</b>		
3. 197	Prishje shtrese çakelli t = 10 cm, me makineri	m2	570
3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2	470
3.212/c	Shtrese stabilizant t=15cm	m2	100
3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	210
3.969	Skarifim shtrese asfalti ekzistues me makineri	m2	10271
3.164/1a	Mbushje me material të germuar në trupin e rrugës, përhapur e ngjeshur me makineri	m3	210
	<b>3. ANALIZA TEKNIKE</b>		
3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave, 6cm, me makineri	m2	10271
3.226/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2	10271
	<b>4. PUNIME BETONI E BETONARMEJE</b>		
3. 244	Struktura monolite betoni C 20/25	m3	43
3. 235	Struktura monolite b/betoni C 12/15 me 20% gur	m3	192
	<b>5. PUNIME HEKUR BETONI 3</b>		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

3. 287	F V hekur betoni i zakonshem $\varnothing$ 6 ~ 10mm	ton	0.6
3. 288	F V hekur betoni i zakonshem $\varnothing$ > 12mm	ton	2.3
	<b>6. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT +KANALIZIME</b>		
3. 323	Mur guri mbajtes e themele, llaç çimento M50	m3	244
3. 396	Mbushje me cakell pas mureve	m3	174
3. 332	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x1.5 m	m3	20
3. 405	Prishje struktura prej guri	m3	10
3. 366	Tombino me tuba betoni $\varnothing$ 800, mbi shtrese betoni	ml	8
	<b>7. PUNIME TE NDRYSHME</b>		
3. 618	FV Bordura betoni 20x35 cm	ml	50
	<b>8. D. SINJALET DHE PAJISJET SHTESE, NGADALSUESIT E SHPEJTESISE</b>		
3.948/1	F.v.kurrize artificiale h =5cm	copë	6
3.949/1	Vizime me boje bikomponente me gjeresi 15 cm	ml	9060
3. 953	FV tabela rrugore treguese 150x40cm	copë	28
3. 955	FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm	copë	38
	<b>11. TE NDRYSHME ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA</b>		
3.921/1	F.v. Tabele katrore normal me A=60	copë	22
3.936/1	F.v. Tabela trekendore normal me A = 90	copë	28
3.935/1	F.v. Tabele rrethi "ndalim" normal me D = 60	copë	24
3.933/1	F.v. Tabela tetekendore normal me A-B, 90-30	copë	8



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR

3.941/1	F.v. Pervijues normal anesor	copë	120
3.941/3	F.v. Pervijues modulare te kthesave (teke)	copë	45
3.941/4	F.v. Pervijues modulare te kthesave (qyfte)	copë	38
3.941/5	F.v. Pervijues kthese e ngushte ose e forte(ne forme T)	copë	22
3.186	F.V guardrail- H1 anesore me 2 valz.e ne 1 ane , W3	ml	984

*Foto nga inspektimi në terren.*

Gjatë inspektimit në terren janë fotografuar dhe disa nga problematikat aktuale të akseve rrugore. Bashkangjitur janë fotot e realizuara në terren dhe tabelat e shperndarjes se punimeve rehabilituese periodike:





REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR







REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORIA E RAJONIT VERIOR



**GRUPI I PUNËS :**

